

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtari Enes Mehmeti, në çështjen juridike të paditëses [REDACTED] Ferizaj, të cilën e përfaqëson [REDACTED] me autorizim, kundër të paditurve, [REDACTED] dhe [REDACTED], nga fshati R [REDACTED] për pagimin e borxhit, vlera e kontestit 145 €, pas seancës publike të mbajtur më 23.02.2015, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe në mungesë të paditurve mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditëses, [REDACTED]

**DETYROHET** të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED], që paditëses t'i paguajnë shumën prej 145 €, në emër të borxhit të cilin borxh e kanë krijuar me rastin e marrjes së kredisë, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 40 €, të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Përfaqësuesi i paditëses në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë duke theksuar se paditësja ka lidhur kontratë për dhënien e kredisë me të paditurit në shumë prej 300 €, të cilën kredi të paditurit kanë qenë të obliguar ta paguaj për periudhën prej 9 muaj me këste mujore, por të njëjtit kanë paguar vetëm një pjesë dhe pjesën tjetër nuk iu kanë përgjigjur.

Pasi që kontrata për kredinë është përmbushur pjesërisht dhe ka mbetur pa paguar shumën prej 145€ nga ana e të paditurve ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesë padinë ta aprovon si të bazuar.

Ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestuese.

Nga fletkthesa e ardhur shihet se ftesën e ka pranuar [REDACTED] i cili në këtë çështje juridike është në cilësi të bashkëhuamarrësit dhe bashkëndërgjygjësit unik ku pranimi i ftesës nga njëri i paditur ka efekt edhe ndaj tjetërit mungesën nuk e kanë arsyetuar andaj gjykata seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurve, në kuptim të 423.4 të LPK-së.

Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë leximin e tyre: Lexohet padia e paditëses e dt.17,05,2012, kontrata për kreditë e shpejt e datës 19,10,2010, orari për kthimin e kredisë, kopja e letërnjoftimit të paditurve

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e bazuar ashtu siç është aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga provat e administruara u vërtetua se të paditurit kanë lidhur kontratë për marrjen e kredisë me paditësen në shumë prej 300€, të cilën shumë pjesërisht e kanë paguar kurse kanë mbetur pa paguar shumën prej 145€ siq shihet nga pasqyra e pagesës e cila vërtetohet me faktin se të paditurit me paditësen janë në raport juridiko-civil ndërmjet vete sipas nenit 26 LMD-së dhe nga ky raport janë krijuar të drejtat dhe detyrimet në kuptim të nenit 148 lidhur me nenin 1065 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara kontrata e kredisë.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej, 20 € dhe aktgjykim prej, 20 €, gjithësej në lartësi prej 40 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr. 333/12 më dt.23.02.2015

Gjyqtari  
Enes Mehmeti



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më  
Dana 01.06.2015

